



Deklarata e të drejtave

I PARAQITET NJË PERSONI TË VENDOSUR NËN ARREST TË MITUR MBI 16 VJEÇ, BASHKAUTOR OSE BASHKËPUNËTOR ME NJË TË RRRITUR QË KA KRYER NJË SHKELJE SIPAS NENIT 706-73 TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE

Informacionet e mëposhtme duhet t'ju jepen në një gjuhë që e kuptoni.

Mbajtësit e autoritetit prindëror do të marrin të njëjtat informacione, përveçse kur është kundër interesave tuaj më të mira ose dyshohet se dëmton procedurën.

Ju mund ta ruani këtë dokument gjatë gjithë kohës që ndodheni nën arrest.

Ju informojmë se jeni nën arrest policor sepse ndaj jush ekzistojnë një ose më shumë arsye të besueshme për të dyshuar se keni kryer ose jeni përpjekur të kryeni, si bashkautor ose bashkëpunëtor me një të rritur, një shkelje që konsiderohet si kriminalitet ose krim i organizuar e ndëshkueshme me dënimin me burg.

Keni të drejtë të njiheni me përshkrimin, datën dhe vendin e supozuar të kryerjes së shkeljes për të cilën akuzoheni dhe arsyet që justifikojnë vënien tuaj nën arrest.

Ju do të pyeteni rreth këtyre fakteve gjatë mbajtjes nën arrest i cili mund të zgjasë 24 orë.

Në fund të kësaj periudhe, prokurori (gjykatësi i hetimeve ose gjykatësi i fëmijëve) mund të vendosë për zgjatjen e mbajtjes nën arrest me 24 orë të tjera. Ju do të paraqiteni para këtij magjistrati, kur është e nevojshme me video-konferencë.

Në raste të jashtëzakonshme, dhe nëse nevojitet ose për arsye hetimi, mund të vendosen dy zgjatje shtesë, për një periudhë kohore prej 24 orësh secila, qoftë nga gjykatësi i lirimit dhe ndalimit qoftë nga gjykatësi i hetimeve paraprake.

Megjithatë, në qoftë se justifikohet nga kohëzgjatja e parashikuar e hetimeve të mbetura pas 48 orëve të para, gjykatësi i lirimit dhe i ndalimit, me kërkesë të prokurorit ose gjykatësi i hetimeve paraprake mund të vendosë që periudha e arrestit të zgjatet vetëm një herë për një periudhë prej 48 orësh.

Në përfundim të periudhës së arrestit, me urdhër të prokurorit ose gjykatësit të hetimeve ju, ose do të paraqiteni përpara këtij gjykatësi, ose do të liroheni. Në rastin e parë, do të paraqiteni para këtij magjistrati në të njëjtën ditë. Nëse ka premisa për rrethana të veçanta brenda juridiksionit dhe arresti juaj nuk i ka kaluar 72 orët, mund të paraqiteni ditën pasuese, por jo më vonë se 20 orë nga përfundimi i periudhës së arrestit. Nëse arresti juaj ka zgjatur më shumë 72 orë, do të paraqiteni para magjistratit në të njëjtën ditë që përfundon edhe periudha e arrestit.

Ju informojmë gjithashtu se keni të drejtë:

Të njoftoni disa persona

Prindërit e tu ose tutori yt, ose personi apo shërbimi të cilit i jeni besuar, do të informohen detyrimisht për masën e arrestit së cilës i jeni nënshtruar, si edhe për përshkrimin, datën dhe vendin ku është kryer akti për të cilin akuzoheni.

Mund të kërkonti që të njoftoni me telefon një person me të cilin banoni rregullisht, ose një nga të afërmit tuaj të ngushtë, ose një nga vëllezërit ose motrat e tua, ose kujdestarin apo tutorin tuaj lidhur me masën e arrestit së cilës i jeni nënshtruar.

Gjithashtu, mund të njoftoni punëdhënësin tuaj.

Nëse jeni shtetas i huaj, mund të njoftoni gjithashtu autoritetet konsullore të vendit tuaj.

Me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, këto procedura do të kryhen jo më vonë se 3 orë nga momenti kur keni bërë kërkesën.

Prokurori (gjykatësi i hetimeve ose gjykatësi i fëmijëve) mund të vendosë, gjithsesi, që këto njoftime të shtyhen për më vonë ose të mos jepen, nëse kjo është e domosdoshme për mbledhjen ose ruajtjen e provave ose për të parandaluar pasoja serioze për jetën, për lirinë ose për integritetin fizik të një personi. Në të kundërt, shtyrja e njoftimit ndaj përfaqësuesve tuaj ligjorë nuk mund

të kalojë 24 orë nëse vënia në arrest mund të zgjatet me dymbëdhjetë orë.

Nëse periudha e arrestit tuaj zgjatet përtej 48 orëve, shtyrja e njoftimit për të afërmit tuaj dhe për punëdhënësin tuaj mund të bëhet për të njëjtat arsye, nga gjykatësi i lirimit dhe i ndalimit (ose nga gjykatësi i hetimit).

Të komunikoni me një person

Mund të kërkonti të komunikoni me shkrim, me telefon ose gojarisht me një nga personat që u takon të informohen për vendosjen tuaj nën arrest.

Nëpunësi i policisë gjyqësore mund ta refuzojë kërkesën tuaj nëse ajo nuk përputhet me arsyet e arrestit tuaj ose nëse rrezikon që të përbëjë një shkelje. Ai do të përcaktojë momentin, mënyrën dhe kohëzgjatjen e këtij komunikimi, i cili nuk mund të jetë më shumë se 30 minuta dhe do të kryhet nën mbikëqyrjen e tij ose të një personi të caktuar prej tij për këtë qëllim.

Nëse periudha e arrestit zgjatet përtej 48 orëve, nëpunësi i policisë gjyqësore nuk mund ta refuzojë kërkesën tuaj për të komunikuar me autoritetet konsullore.

Të ekzaminoheni nga një mjek

Ju mund të kërkonti të kontrolloheni nga një mjek që nga momenti që vendoseni nën arrest dhe në rastin e zgjatjes së masës së arrestit. Nëse periudha e arrestit tuaj zgjatet përtej 48 orëve, ju do të ekzaminoheni detyrimisht nga një mjek dhe do të informoheni që keni të drejtë për të kërkuar një kontroll të ri mjekësor. Këto kërkesa mund të bëhen po njësoj nga prindërit tuaj, nga tutori yt ose nga personat apo institucionet të cilëve u jeni besuar.

Po ashtu, avokati juaj mund të kërkojë që t'i nënshtroheni një ekzaminimi mjekësor.

Të bëni deklaratat, t'u përgjigjeni pyetjeve ose të rritni në heshtje

Pasi të keni pohuar identitetin tuaj, keni të drejtë që gjatë seancave :

- të bëni deklaratat,
- t'u përgjigjeni pyetjeve që ju bëhen,
- ose të mos flisni.

Të shoqëroheni nga përfaqësuesi juaj ligjor

Nëse autoritetet kompetente e vlerësojnë të nevojshme ju mund të jeni i shoqëruar, gjatë seancave ose marrjeve në pyetje, nga mbajtësi i autoritetit prindëror. Nëse është e përshtatshme, ju mund të caktoni një të rritur tjetër që të jetë shoqëruesi juaj ose mund t'ju shoqërojë një i rritur i caktuar nga gjykata.

Të asistoheni nga një avokat

Ju duhet të përfitoni detyrimisht asistencën e një avokati.

Zgjedhja e avokatit

Që nga fillimi i periudhës së arrestit, në çdo moment gjatë një seance dhe në rastin kur zgjatet arresti, që nga fillimi i kohës së zgjatjes, mund të kërkonti të asistoheni nga një avokat i zgjedhur nga ju. Nëse ju nuk mund të caktoni një avokat ose nëse avokati i zgjedhur nuk mund të kontaktohet, nëpunësi i policisë gjyqësore ose prokurori (gjykatësi i hetimit ose gjykatësi i fëmijëve) do të kërkojë që të asistoheni nga një avokat i caktuar nga gjykata.

Avokati juaj mund të caktohet gjithashtu nga prindërit e tu ose nga tutori yt, ose nga persona apo shërbimet të cilëve u jeni besuar.

Asistenca dhe koha e ndërhyrjes së avokatit

Avokati do të mund të flasë me ju për 30 minuta me kusht që të garantojë konfidencialitetin e bisedës: në rastin e zgjatjes së arrestit, mund të kërkonti përsëri që të takoheni me avokatin;

Nëse bëni kërkesë, ai gjithashtu mund të asistojë gjatë seancave të marrjes në pyetje, në ballafaqimet, në rindërtimin e fakteve ose në seancat e identifikimit ku ju merrni pjesë.

Në këtë rast, seanca e parë e marrjes në pyetje, me përjashtim të rastit kur përfshihen elementë të identitetit, nuk mund të fillojë pa praninë e avokatit tuaj i cili duhet të mbërrijë brenda 2 orëve nga momenti që njoftohet për kërkesën tuaj. Megjithatë, seanca juaj e parë e marrjes në pyetje mund të fillojë menjëherë, qoftë dhe në mungesë të avokatit tuaj, me autorizimin e prokurorit ose të gjykatësit të hetimeve, nëse kjo është e nevojshme për arsye hetimi.

Nëse avokati mbërrin pasi seanca e marrjes në pyetje ose ballafaqimi të ketë filluar, atëherë ky veprim mund të ndërpritet me kërkesën tuaj, në mënyrë që konsultoheni me avokatin.

Megjithatë, prokurori, gjykatësi i hetimeve ose gjykatësi për lirim dhe për ndalimin, për shkaqe detyruese ose të jashtëzakonshme, mund të vendosë që ta shtyjë praninë e avokatit tuaj në seancat e marrjes në pyetje ose në ballafaqimet, për një periudhë maksimale prej 12 orësh, që mund të rinovohet një herë, nëse rrezikohet dënimi me burg prej të paktën pesë vjetësh.

Të asistoheni nga një përkthyes

Nëse nuk flisni ose nuk kuptoni frëngjisht, keni të drejtë që gjatë seancave të marrjes në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj të asistoheni pa pagesë nga një përkthyes.

Të kërkonti përfundimin e arrestit

Kur prokurori, ose gjykatësi i hetimeve ose gjykatësi i lirit dhe i ndalimit të shprehet për një zgjatje të mundshme të masës së arrestit, ju mund t'i kërkonti këtij magjistrati që kjo masë të mos zgjatet.

Të keni akses në disa pjesë të dosjes suaj

Me kërkesën tuaj ose të avokatit tuaj, mund të kërkonti të konsultoheni, jo më vonë se para zgjatjes së mundshme të arrestit tuaj :

- me proces-verbalin e njoftimit të vënies suaj nën arrest ;
- me certifikatën ose certifikatat mjekësore të përgatitura nga mjeku që ju ka ekzaminuar.
- me proces-verbalin ose proces-verbalet e seancave të marrjes suaj në pyetje.

T'i paraqitni komente prokurorit publik

Pas përfundimit të periudhës së arrestit, në fund të periudhës një vjeçare, mund t'i kërkonti prokurorit publik me anë të një letre rekomande të regjistruar me njoftim marrjeje ose me anë të një deklaratë të bërë para regjistratit të gjykatës kundrejt faturës, që të konsultoheni me regjistrimet e procedimeve me qëllim që të bëni komente.

E drejta për mbrojtjen e privatësisë

Me përjashtim të pamundësisë teknike, seancat gjatë të cilave do t'i nënshtroheni kësaj mase do të jenë detyrimisht të filmuara. Është e ndaluar për këdo që të shpërndajë regjistrimet e këtyre seancave.

Këto regjistrime lejohen të shpërndahen vetëm kur në seancën që mbahet me dyer të mbyllura është i ndaluar publikimi i procesverbalit të debateve të seancës ose i çdo elementi tjetër që bën të mundur identifikimin tuaj.